



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline

Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbr. i Mjedisit
Odelenje za Urbanizam, Planiranje i Zašt. Sredina
Nr. i prot. 02 MS 05.01.2026
-XII- Br. RAHOVEC - GRAF

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2025

JANAR, 2026

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT *DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT*

Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave duke u bazuar në obligimet që dalin nga Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligji Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ligji Nr.06/L-024 për trajtimin e Ndërtimeve pa Leje dhe Statuti të Komunës Nr. 1005 i datës 29.03.2017. Raport në bazë të punëve të cilat janë realizuar gjatë vitit 2025 nga Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Në kuadër të Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksionojnë dy sektorë,

- Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,
- Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Gjatë vitit 2025 në Drejtorinë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit janë pranuar gjithsej 382 kërkesa, prej tyre 356 në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit, 26 në sektorin Mjedisit.

Të hyrat

| Viti | 2023 | 2024 | 2025 |
|----------|-----------|-----------|------------|
| Të hyrat | 66,899.87 | 62,421.61 | 108,398.25 |

SEKTORI I URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT

Në vitin 2025 zyrtarët e Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit nga sektori për Urbanizëm dhe Planifikim janë angazhuar në lehtësimin e procedurave për aplikimin e lejeve të ndërtimit, kërkesave të qytetarëve, investitorëve. Në aspektin e planifikimit hapësinor dhe urban brenda afatit ligjor janë trajtuar kërkesat, janë dhënë kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit për objektet të cilat janë në harmoni me planet urbanistike që janë të miratuara në Kuvendin e Komunës, sipas Plani Zhvillimor Komunal në fuqi. Për marrjen e kushteve ndërtimore dhe lejes së ndërtimit janë dorëzuar së bashku me dokumentacionet e nevojshme edhe projektet ideore dhe projektet zbatuese të cilat janë pranuar nga zyrtarët përgjegjës, me ç' rast është bërë kontrollimi i tyre. Po ashtu janë dhënë edhe pëlqime.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit jan shqyrtuar:

| | JANAR - DHJETOR - 2025 | | | | | |
|-----------------------|------------------------|------------|-----------|-------------|----------|-----------|
| Kërkesat | Nr.total | Aprovuar | Refuzuar | Në shqyrtim | Ceduar | Hudhet |
| Leje ndërtimi | 68 | 68 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Leje përdorimi | 3 | 2 | 0 | 1 | | 0 |
| Leje rrënimi | 12 | 10 | 0 | 2 | | 0 |
| Kushte ndërimore | 102 | 81 | 4 | 3 | 1 | 13 |
| Shkresë | 94 | 70 | 10 | 8 | 4 | 2 |
| Pelqim | 36 | 28 | 1 | 4 | 2 | 1 |
| Legalizim i objekteve | 41 | 31 | 0 | 10 | | 0 |
| Gjithësej | 356 | 290 | 15 | 28 | 7 | 16 |

Të hyrat e përgjithshme

Janar – Dhjetor –2025

| | |
|---------------------------|--------------------|
| Parallogaria | 95695.06 € |
| Leje rrenimi | 35 € |
| Leje perdorimi | 80 € |
| Vertetim –Pelqim | 1400 € |
| Legalizim | 8327.64 € |
| Totali i të hyrave | 105 537.7 € |

SEKTORI I MJEDISIT

Në bazë të Sektorit të mjedisit leshojm Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

| Janar -Dhjetor 2025 | | | | | |
|---------------------|----------|----------|----------|-------------|--------|
| | Nr.total | Aprovuar | Refuzuar | Në shqyrtim | Hudhet |
| Leje mjedisore | 26 | 24 | 0 | 2 | 0 |
| Gjithësej | 26 | 24 | 0 | 2 | 0 |
| Totali i të hyrave | | | | 2860.55euro | |

Lejet Mjedisore të Lëshuara gjatë Vitit

1. Numri i lejeve mjedisore të lëshuara: 24
2. Kërkesat për leje mjedisore komunale: 26

15.1.3 Ndërtesat e Reja që kanë zbatuar lejet mjedisore komunale

1. Numri i objekteve të reja për të cilat kërkohet leja mjedisore dhe që janë inspektuar gjatë vitit të raportimit: 24
2. Numri i objekteve që janë pajisur me leje mjedisore komunale: 24
3. Numri i objekteve që kanë LMK (Leje Mjedisore Komunale) dhe e zbatojnë atë: 24

Sistemi i Adresave

Në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës, është angazhuar stafi mbështetës për rrjedhën e procesit të kompletimit të sistemit të adresave.

Detyrë kryesore e zyrtarit të angazhuar është harmonizimi i numrit të hyrjeve me dokumentet personale, duke siguruar përputhshmëri dhe saktësi në regjistrimin e të dhënave.

Hartimi i Hartës Zonale 2026–2033

Drafti i Hartës Zonale 2026–2033 është dorëzuar te Ministri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për marrjen e pëlqimit për hapjen e shqyrtimit publik.

Pas marrjes së pëlqimit, dokumenti do të vendoset në diskutim publik për një periudhë prej 30 ditësh, me qëllim përfshirjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin e konsultimit.

Ndërtimi i Sheshit Qendror në Qytet

Sheshi Qendror përfaqëson projektin më të madh të realizuar ndonjëherë në Komunën e Rahovecit. Punimet gjatë vitit 2025 kanë vazhduar me dinamikë të rregullt, sipas planit të menaxhimit.

Gjatë kësaj periudhe ka përfunduar:

- * Ndërtimi i dy parkingjeve, tashmë në shfrytëzim nga qytetarët.
- * Ndërtimi i unazës së shëtitores në shesh.
- * Krijimi i ishujve gjelbërues, një pjesë e të cilëve është mbjellë me drunj dekorativ.

Ky projekt synon të ofrojë hapësirë funksionale, estetike dhe të gjelbër për komunitetin, duke e bërë sheshin qendror një pikë referimi të re për qytetin.



Ndërtimi i rrugës në qytet Ibrahim Rugova, Rr. Xhelal Hajda, Rr. Muharem Dina

Në pjesën e parë të vitit 2025, kemi përfunduar dhe unazë përgjatë sheshit qendror ku janë lidhurë tre rrugë egzistuese, është krijuar qasje për qerdrën e femijve, është ndërtuar trotuari dhe shtegu i qiklistve dhe për herë të parë janë vendosur edhe konstruksionet për hardhin e rushit dhe janë mbjedhure për gjatë rrugës.

Trajtimi i shtretërve të përenjëve në Komunën e Rahovecit- Faza e Parë

Gjatë vitit 2025, është përfunduar rregullimi i shtretërve të përenjëve në fshatin Polluzhë dhe Malësi e Vogël, me këtë ka përfunduar edhe kjo kontratë.

Projektet në fazën e realizimit

- Ndërtim i Sheshit Qendror të Qytetit
- Ndërtimi i Ballkonit Panoramik, mbi qytetin e Rahovecit
- Ndërtimi i kolektorit dhe shtratit të lumit në Hoçë të Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe.
- Rregullimi i shtratit të lumit Rimnik - Fortesë
- Rregullimi i shtratit të lumit në Krushë të Madhe
- Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit
- Ruajtja dhe trajtimi i vlerave të trashëgimisë kulturore dhe krijimi i sigurisë së lëvizjes në qytetin e Rahovecit



Drejtori:

Albnor Mullabazi